



Republika e Kosovës / Republic of Kosovo
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/ Nr.8620/2022

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040 neni 40, Ligji për Ndërmarrjet Publike Nr. 03/L-087 neni 30, Statuti i Komunës së Hanit të Elezit neni 52, Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit në mbledhjen e mbajtur me datë 27.10.2022 merr:

VENDIM

PËR MIRATIMIN E PLANIT TË BIZNESIT PËR VITIN 2023 PËR NDËRMARRJEN PUBLIKE
LOKALE PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE PËR NPL "PASTRIMI" SH.A HANI I ELEZIT

1. Kuvendi i komunës miratoi vendimin për planin e biznesit për vitin 2023 për Ndërmarrjen Publike Lokale për Menaxhimin e Mbeturinave N.P.L "PASTRIMI" SH.A Hani i Elezit.
2. Plani i biznesit për vitin 2023 për Ndërmarrjen Publike Lokale përmban gjithsej 20 (njëzet) faqe dhe është pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas protokollimit të autoritetit mbikëqyrës dhe 7 ditë pas publikimit në ueb – faqen zyrtare të komunës.

Me këtë vendim njoftohen:

- Kryetari i Komunës,
- N.P.L Pastrimi SH.A,
- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe
- Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit

Data: 27.10.2022





Republika e Kosovës / Republic of Kosova
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/Nr. 9197 /2022

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 neni 40.2, Statutin e Komunës së Hanit të Elezit me numër 01/Nr.7703/2018 neni 79, 80, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 27.10.2022 merr:

VENDIM

**PËR PLOTSIM NDRYSHIMIN E RREGULLORES PËR TRANSPORT RRUGORË NË
TERITORIN E HANIT TË ELEZIT**

1. Me këtë vendim aprohet plotësim ndryshimi i rregullores për transport rrugorë në teritorin e Hanit të Elezit.
2. Plotësim ndryshimi i rregullores për transport rrugorë në teritorin e Hanit të Elezit lëshohet në procedurë të diskutimit publik me qytetarët.
3. Obligohet Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë që t'i zhvilloj procedurat e diskutimit publik me qytetarët dhe ekzekutivin e komunës dhe pas kësaj rezultatet e diskutimit publik t'i paraqet në Kuvendin e Komunës për finalizimin e Plotësim ndryshimi i rregullores për transport rrugorë në teritorin e Hanit të Elezit
4. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Plotësim ndryshimi i rregullores për transport rrugorë në teritorin e Hanit të Elezit

Me këtë vendim njoftohen:

- Kryetari i Komunës,
- Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë (përmes kësaj drejtorie njoftohen organet përkatëse),
- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe
- Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit
Data: 27.10.2022





Republika e Kosovës / Republic of Kosovo
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/Nr. 8613 /2022

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 neni 11, 40, Ligjin mbi Menaxhimin e Financave Publike 03/L-048 neni 45.4, Statutin e Komunës së Hanit të Elezit neni 64, Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit në mbledhjen e mbajtur me datë 27.10.2022 merr:

VENDIM

PËR MIRATIMIN E RAPORTIT FINANCIAR PËR PERIUDHËN JANAR-SHTATOR 2022

1. Kuvendi i komunës miratoi vendimin për raportin financiar për periudhën Janar - Shtator 2022.
2. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është raporti i financiar për periudhën Janar- Shtator 2022 i hartuar nga Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

Buxheti i miratuar për vitin fiskal 2022 është në shumë prej 2,759,758.00 €, Ndërsa buxheti përfundimtarë është 2,942,586.08 €, ku në këtë shumë përfshihen: Bartja e të hyrave vetanake të pa shpenzuara të vitit 2020 dhe 2021 në vlerë prej 72,737.76 €, Grant shtesë për projektin kapital "Shtimi i kapaciteteve të ujit dhe rregullimi i rrjetit të ujësjellësit" në vlerë prej 37,150.00 €, Donacion prej IPA Fondeve për projektin "Mbrotja e mjedisit përmes përmirësimit të ujërave të zeza dhe Kanalizimeve Atmosferike" në shumë prej 64,140.32 €. Në kategorinë Paga dhe shtesa shpenzimi është në shumë prej 1,168,274.23 € apo 66.53%, në kategorinë mallra dhe shërbime shpenzimi është në shumë prej 216,450.22 € apo 56.08%, në kategorinë ekonomike shërbime komunale shpenzimi është në shumë prej 43,589.27 € apo 64.39%, në kategorinë ekonomike subvencione dhe transfere shpenzimi është në shumë prej 67,650 € apo 84.56%, në kategorinë ekonomike shpenzime kapitale kemi shpenzuar 208,714.90 € apo 45.87% . Totali i shpenzimit për periudhën Janar - Shtator të vitit 2022 është në shumë prej 1,704,678.62 € apo 61.77 %. Komuna e Hanit të Elezit ka arritur të arkëtoj gjithsej 264,541.72 € për periudhën janar-shtator 2022 dhe paraqesin 67.37 % e planit të të hyrave vetanake, ndërsa në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit 2021 kemi një rritje prej 16,419.20 €.

3. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas protokollimit të autoritetit mbikëqyrës dhe 7 ditë pas publikimit në ueb – faqen zyrtare të komunës.

Me këtë vendim njoftohen:

- Kryetari i Komunës,
- Drejtoria për Buxhet dhe Financa,
- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe
- Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit
Data: 27.10.2022



Kryesuesi i Kuvendit
Florim Shkreta